

## NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Supreme e Kosovës – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Nesrin Lushta, kryetare, Emine Mustafa dhe Rasim Rasimi, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të pandehurve Xh.S. dhe L.D., për shkak të veprës penale keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar në bashkëkryerje nga neni 422 lidhur me nenin 31 të KPK, ndërsa Xh.S. edhe për shkak të veprës penale keqpërdorim i informatës zyrtare nga neni 423 par.2 lidhur me par.1 të KPK, duke vendosur përkitazi me kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë të paraqitur nga Prokurori i Shtetit të Kosovës kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore Prishtinë - DKR, PKR.nr.12/2017 datë 3.7.2017 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, P.nr.548/2017 datë 25.7.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur më 3 prill 2018, mori këtë:

## A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e Prokurorit të Shtetit të Kosovës, paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore Prishtinë - DKR, PKR.nr.12/2017 datë 3.7.2017 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, P.nr.548/2017 datë 25.7.2017.

## A r s y e t i m i

Me aktvendimin e Gjykatës Themelore Prishtinë - DKR, PKR.nr.12/2017 datë 3.7.2017, është refuzuar kërkesa e mbrojtësve të të pandehurve Xh.S. dhe L.D., për pranueshmërinë e provave në bazë të të cilave është ngritur aktakuza, PPS.nr.86/2015 datë 11.1.2017 dhe është vendosur që provat e propozuara nga Prokurori Special i Republikës së Kosovës në këtë çështje penale janë të pranueshme në shqyrtimin gjyqësor. Sipas pikës II të dispozitivit është refuzuar kërkesa e mbrojtësve të pandehurve për hedhjen e aktakuzës dhe çështja penale do të vazhdohet me procedimin sipas aktakuzës së ngritur.

Në procedurën ankimore, Gjykata e Apelit të Kosovës, me aktvendimin Pn.nr.548/2017 datë 25.7.2017, sipas pikës I të aktvendimit e ka refuzuar si e pabazuar ankesën e mbrojtësit të pandehurit Xh.S., e paraqitur kundër aktvendimit të shkallës së parë, ndërsa sipas pikës II ankesa e mbrojtësit të pandehurit L.D., është

aprovuar dhe është ndryshuar aktvendimi i shkallës së parë ashtu që aktakuza e Prokurorit Special, PPS.nr.86/2015 datë 11.1.2017, e ngritur kundër të pandehurit L.D., për shkak të veprës penale e kryer në bashkëkryerje keqpërdorim i detyrës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 lidhur me nenin 31 të KPK, hedhet dhe ndaj të pandehurit L.D., pushohet procedura penale për shkak se nuk ka prova të mjaftueshme që mbështesin dyshimin e bazuar mirë se i njëjti ka kryer veprën penale për të cilën dyshohet.

Kundër këtyre aktvendimeve, kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë ka paraqitur Prokurori i Shtetit të Kosovës, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal me propozim që të konstatohet se aktvendimet e kundërshtuara përmbajnë shkelje të dispozitave të procedurës penale dhe shkelje të ligjit penal.

Përgjigje në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë ka dhënë mbrojtësi i të pandehurit L.D., A.Q., avokat nga P., duke propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e çështjes, vlerësoi pretendimin nga kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë në pajtim me dispozitën e nenit 435 par.1 dhe 436 par.1 të KPPK, dhe konstatoi se:

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk është e bazuar.

Në kërkesë Prokurori i Shtetit të Kosovës, thekson se aktvendimet e kundërshtuara përmbajnë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.2 pika 2.1 e lidhur me nenin 370 par.1 e lidhur me nenin 7 të KPK, sepse konkludimet e gjykatës së shkallës së dytë nuk kanë mbështetje në vlerësimin konkret dhe të drejtë të provave për zgjidhjen e çështjes ndërsa zgjedhjen e kërkon në faqen 1209 pika 4 të Komentarit të Kodit Penal. Në vazhdim, Prokurori citon komentarin në fjalë e më pas edhe një segment nga aktvendimi i shkallës së dytë. Më pas thekson se gjykata e shkallës së dytë në arsyetim nuk ka cekur as burimin në të cilën ka bazuar zgjedhjen juridike të çështjes, duke theksuar e gjykata ka vepruar në kundërshtim me nenin 7 të Kodit Penal të Kosovës, meqë nga përmbajtja e email-eve vërtetohet se i pandehuri Xh.S. ka pasur marrëveshje me të pandehurin L.D., veprimet e të cilëve më pas citohen në kërkesë duke cekur se në mënyrë të kundërligjshme ka këmbyer informacione me të pandehurin Xh.S., me qëllim që të përfitoj nga tenderi e duke vepruar në dëm të kompanive konkurrese. Në vazhdim të kërkesës potencohet se është për t'u habitur se si Gjykata e Apelit në rastin konkret në raport me të pandehurin L.D. nuk vepron siç ka vepruar me të pandehurin Xh.S., duke theksuar se gjykata gabimisht ka vlerësuar provat në raport me këtë të pandehur i cili është akuzuar si bashkëkryesor me të pandehurin e parë, kurse ndaj tij e pushon procedurën penale edhe përkundër faktit se vepra penale nuk do të mund të ekzistonte pa elementin e bashkëkryerjes meqë informacionet janë këmbyer

gjatë procesit të tenderimit në bazë të cilave në dëm të kompanive tjera konkurruese ka përfituar i pandehuri L.D..

Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson si të pabazuara pretendimet nga kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë për këto arsye:

Nga shkresat e çështjes dhe aktvendimi i kundërshtuar rezulton se me aktakuzën PPS.nr.86/2015 datë 11.1.2017, Xh.S. dhe L.D. janë akuzuar për veprën penale keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar në bashkëkryerje nga neni 422 lidhur me nenin 31 të KPK, ndërsa Xh.S. edhe për veprën penale keqpërdorimi i informatës zyrtare nga neni 423 par.2 lidhur me par.1 të KPK.

Në procedurën e kundërshtimit të provave, duke vendosur sipas kërkesave të mbrojtësve të të pandehurve për hedhjen e aktakuzës dhe pranueshmërinë e provave, Gjykata Themelore në Prishtinë me aktvendimin PKR.nr.12/2017 datë 3.6.2017, ka refuzuar kërkesat e ushtruara dhe ka vendosur se në këtë çështje penale do t'u vazhdohet me procedimin sipas aktakuzës së ngritur.

Gjykata e Apelit të Kosovës, në procedurën ankimore me aktvendimin Pn.nr.548/2017 datë 25.7.2017, ka refuzuar ankesën e mbrojtësit të të pandehurit Xh.S., ndërsa ankesën e mbrojtësit të pandehurit L.D. e ka miratuar ashtu që ka hedhur aktakuzën e ngritur kundër këtij të pandehuri dhe ka pushuar procedurën penale në raport me të njëjtin me arsyetim se nuk ka prova të mjaftueshme që mbështesin dyshimin e bazuar mirë se i njëjti ka kryer këtë vepër penale.

Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson si të pabazuara pretendimet nga kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë lidhur me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale për faktin se edhe pse Prokurori i Shtetit e kundërshton aktvendimin e shkallës së dytë për këtë bazë ligjore dhe vetëm e citon dispozitën ligjore dhe thekson se me rastin e zgjedhjes juridike të çështjes, gjykata vendimin e saj e mbështet në komentarin e KPK-së për të theksuar se gjykata ka vepruar në kundërshtim me nenin 7 të KPK, pra në kundërshtim me detyrimin për vërtetimin e plotë dhe të saktë të fakteve sepse nga përmbajtja e email-eve rezulton se ka pasur ky i pandehur ka pasur marrëveshje me të pandehurin e parë Xh.S. Mirëpo nuk precizohet se ku konkretisht manifestohen këto shkelje.

Kjo Gjykatë pretendimet në fjalë i refuzoj si të pabazuara për faktin se sipas dispozitës së nenit 436 par.1 të KPPK përcaktohet se me rastin e vendosjes mbi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, Gjykata Supreme e Kosovës, kufizohet vetëm në verifikimin e shkeljeve ligjore në të cilat paraqitësi i kërkesës pretendon.

Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se konkludimet e gjykatës së shkallës së dytë, në raport me të pandehurin L.D., janë të drejta dhe të bazuara në ligj. Kjo për arsye se në rastin konkret nuk është kontestues fakti se i pandehuri Xh., është person zyrtar i MTI-së në Prishtinë, ndërsa i pandehuri L.D., përgjegjës i Kompanisë

M.. me seli në P. Megjithatë nga shkresat e çështjes, madje edhe në përshkrimin faktik të veprës penale të dhënë në aktakuzë nuk qëndron përshkrimi preciz dhe konkret të veprimeve inkriminuese të cilat i ka ndërmarrë i pandehuri L.D. të cilat do të ndërlidheshin me përgjegjësinë dhe detyrat e tij si person përgjegjës në Kompaninë M.. Aktakuza e Prokurorit të shtetit përveç provave tjera, mbështetet në radhë të parë në korrespondencat përmes email-eve midis të pandehurve, të cilin fakt nuk kanë mohuar as të pandehurit, mirëpo prokurori i shtetit, në kërkesë nuk jep shpjegimet se çfarë vërtetojnë korrespondencat në fjalë dhe cilat informatat ky i pandehur ja kishte dhënë të pandehurit të parë.

Konkludimet e gjykatës së shkallës së dytë lidhur me ekzistimin e veprimeve inkriminuese të pandehurit L.D., janë rezultat i vlerësimit të drejtë të provave në të cilat mbështetet aktakuza, në veçanti kjo rezulton nga përshkrimi faktik i veprës penale nga pika 1 të dispozitivit të aktakuzës nga i cili nuk mund të përcaktohet se cilat veprime konkrete i ka ndërmarrë i pandehuri si person përgjegjës i Kompanisë M., se cila ishte forma e keqpërdorimit dhe të bashkëpunimit e të pandehurit me Xh.S., në realizimin e kësaj vepre penale. Për të gjitha këto gjykata e shkallës së dytë në aktvendimin e saj ka dhënë arsye të qarta ligjore siç janë paraqitur në faqen 5 dhe 6 të aktvendimit, të cilat si të drejta i pranon edhe kjo Gjykatë, meqë në rastin konkret drejt është aplikuar ligji.

Nga arsyet e paraqitura më sipër, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë u refuzua si e pabazuar dhe në pajtim me dispozitën e nenit 437 të KPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË  
Pml.nr.268/2017, më 3 prill 2018

Procesmbajtësi,  
Bujar Balaj

Kryetare e kolegjit,  
Nesrin Lushta